

# 5 PYETJET QË DUHET T'I BËNI MJEKUT, infermieres ose farmacistit në lidhje me ilaçet tuaja

## 1. NDRYSHIME?

A është shtuar, ndalur ose ndryshuar ndonjë nga ilaçet tuaja? Pse?

## 2. NË VAZHDIM?

Cilat ilaçe duhet të vazhdoj t'i marr? Pse?

## 3. PERDORIMI I DUHUR?

Si duhet t'i marr ilaçet e mija dhe për sa kohë?

## 4. MONITORIMI?

Si do e kuptoj nëse ilaçet po bëjnë efekt? Cilat janë efektet anësore për të cilat duhet të kem kujdes?

## 5. INTERESIMI?

A kam nevojë për ndonjë analizë tjetër dhe kur mund të caktoj vizitën e radhës?



**Mbani shënimet tuaja mjekësore të përditësuar.**

**Mos harroni të përfshini:**

- ✓ alergjitë ndaj ilaçeve
- ✓ vitaminat dhe mineralet
- ✓ produktet e herboristerisë dhe ato natyrale
- ✓ të gjitha ilaçet duke përfshirë edhe ato që merren pa recetë

Pyesni doktorin, infermierën ose farmacistin që të rishikojnë të gjitha ilaçet tuaja dhe të vendosin nëse duhet të ndalin ose të reduktojnë dozat e ndonjë ilaçi.